

RUZHDI STRINGA

FJALË TË HUAJA – HUAZIME DHE PRURJE TË HUAJA

Gjuhët asnjëherë nuk kanë qenë të vetmuara e pa marrëdhënie me njëra-tjetrën. Ky fakt është njohur që herët nga gjuhëtarët tanë¹. Veprimi është historik dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Më të dukshme janë këto ndërveprime në fushën e leksikut, ku **shëtitja e fjalëve**² dokumentohet mirë. Madje, kjo shëtitje nuk është vetëm dydrejtimëshe, d.m.th. ndërmjet dy gjuhëve, por edhe ndërmjet më shumë gjuhësh njëra pas tjetrës. Në kushte të caktuara historike fjalët përvetësohen nga gjuhët marrëse dhe shqiptohen e shkruhen sipas ligjësive fonetike e drejtshkrimore të secilës gjuhë dhe kështu ndodh **fytyrëzimi** (nativizimi)³, në rastin e shqipes, **shqipëzimi** i tyre, i cili është i ndryshëm në kohë të ndryshme dhe përbën hapin e parë në rrugën e përvetimit a të shkrirjes (integritimit) së fjalëve të huaja në leksikun vendës. Duhet thënë gjithashtu se leksiku i jashtëardhur i një gjuhe e ka një burim fillestar që për ca gjuhë është i drejtpërdrejtë (i parë), për ca të tjera i ndërmjetësuar (i dytë, i tretë etj.). Kështu, fjalët etruskiste, për të cilat është shfaqur mendimi se kanë lidhje me shqipen⁴, *poplo* dhe *phersu* u morën nga latinishtja dhe u përshtatën në formën *populus* dhe *persona*. Prej këndeje ato shkuan në shumë gjuhë të Evropës, duke përfshirë edhe shqipen, e cila përftoi trajtat *popull* e *person*. Po kështu, ebraishtja *Pësah* shkoi në latinisht në trajtën *Pascha* që shëtitte në shumë gjuhë të Evropës. Në shqip u përftua trajta *Pashkë*, ku, siç duket, ca fjalë “Ato më të moçmet kanë kryer ndërrimin e s-së në sh”⁵. Sot ky ndërrim mezi mbijeton, sepse leksiku i jashtëardhur futet në shtyp dhe në ligjërimin e folur të mjeteve të informimit masiv, pa u kujtuar për shqipëzimin e tij, me fytyrë gjuhësore fare të huaj, madje

¹ Bogdani shkruan: “...huan ghiuhësisht konfinjëto” në Cuneus profetarim, Padovë 1685, f. XXXIX.

² **fjalë të afërta (cognate)** Dy ose më shumë fjalë apo shprehje të karakterizuara nga marrëdhënie ndërgjuhësore gjenetike ose thjesht ndërgjuhësore. Fjalë të një gjuhe të cilat janë të ngjashme në formë dhe në kuptim me fjalë të një gjuhe tjetër, për arsye se të dyja gjuhët kanë lidhje gjenetike, pra ndajnë të njëjtën origjinë (dublet), p.sh. ang. *brother* dhe gjerm. *Bruder*. Ka, në dy ose më shumë gjuhë, edhe fjalë të ngjashme në formë dhe kuptim, që nuk kanë marrëdhënie gjenetike, por që janë thjesht nativizime (fytyrëzime), p.sh. *ulluk* është turqizim i fjalës shqipe *lug*, *shën* (Valentini) është shqipëzim i fjalës latine *san* (Valentino), *kampuni* në gjuhën afrikane Swahili është nativizim (fytyrëzim) i fjalës angleze *company*.

³ **fytyrëzim, nativizim (nativisation)**/ Asimilimi (përvetimi) i fjalëve të huaja në një gjuhë të caktuar. Fytyrëzimi i shndërron fjalët e huaja në huazime duke i bërë pjesë të fondit të leksikut indogjen.

⁴ Z. Mayani, *Etruskishtja dhe shqipja*, Konferenca e studimeve albanologjike, T. 1965.

⁵ E. Çabej, *Studime gjuhësore III*, P. 1976, f. 138.

kalohet në naivitete shkencor, kur edhe zyrtarizohen trajta të tilla si *higjienë*⁶ p.sh., ku dyzanorshi *ie* s'arrin të shqiptohet gjatë aktit të ligjërimin, sepse nuk i ka rrënjët në gjuhën shqipe. Ky është një rast ku sjellja gjuhësore e intelektit tonë pengon edhe ligjërisht shqipëzimin popullor, që, më së shumti, udhëhiqet nga instinkti i gjuhës së nënës dhe "...në qoftë se (termat e huaj) nuk mund t'i zëvendësojmë me përgjegjëset shqipe apo nëse nuk mund t'i shqipërojmë si duhet, së paku duhet të kujdesemi që t'i përdorim sipas rregullave zhvillimore fonetike të gjuhës sonë"⁷. Nëse veprohet kështu si deri tani (media shqiptare e viteve '90 e këtij e pasqyron mirë mosveprimin e ligjeve të brendshme të gjuhës shqipe), atëherë ka shumë mundësi që shëtitja e fjalëve nëpër gjuhë të ndryshme të humbë një stacion, atë të gjuhës shqipe. Fjalët pra, shëtisin, por çdo gjuhë ia nënshtron formësimin e shqiptimit ligjësive të veta gjuhësore, duke ruajtur kështu origjinalitetin, tipar i rëndësishëm ky, siç u vu në dukje, i kulturës së gjuhës. Kështu, duke shtjelluar më tej latinizimin e etruskishtes *poplo* në *populus*, kemi italishten *popolo*, frëngjishten *peuple*, spanjishten *pueblo*, anglishten *people* etj. Shëtitja e fjalëve është fakt i gjallë, por edhe i largët në kohë, që kushtëzohet nga ngjarje të rëndësishme dhe marrëdhënie ndërgjuhësore që lindin vazhdimisht në fushën e shkencave natyrore, shoqërore, ekonomike etj. P.sh., duke udhëtuar nga njëra gjuhë në tjetrën, erdhën nëpërmjet spanjishtes edhe në shqip emra të fushës bujqësore, si *patate*, *domate*, *kakao* etj. Në kohën e sotme, kjo shëtitje fjalësh mund të vërtetohet me leksikon kompjutor me burim nga anglishtja, shpërndarë pothuaj në të gjitha gjuhët e botës. Dhe në këtë leksik, që mund të konsiderohet si leksiku i shkencës së shekullit të kaluar, shenja e parë dalluese që vihet re në rugën e shkrirjes apo ngjizjes së tij në çdo gjuhë, është fytyrëzimi, p.sh. ja disa nga ndalesat e fjalës angleze *computer* gjatë shëtitjes nëpër gjuhë të ndryshme të botës: gjerm. *computer/rechner*, it. *computer*, span. *computador/ordenador*, serb/kro. *kompjuter*, pol. *komputer*, etj. Në shqip hasim një sërë formash të dhënies së kësaj fjale me gojë dhe të paraqitjes me shkrim, për shkak se bartësit e shqipes së sotme imitojnë gjuhë të ndryshme dhe nuk ka forcë ligji i nativizimit (fytyrëzimit). Më të shpeshtat që kemi ndeshur janë: *kompjutër*, *kompjuter*, *kompjuter*, *komputer* etj., pa përmendur format tërësisht të kopjuara me *c* nistore. Sot nuk ka asnjë arsye që shqiptarët të mos e marrin këtë fjalë drejtpërdrejt nga burimi i parë, anglishtja. Marrja nga burime të ndërmjetme, që bëhet për shkaqe parapëlqimesh vetjake, në kushtet e mungesës së normës, do të krijonte në gjuhën shqipe, ashtu siç ka krijuar, dytorë a trisorë të panevojshëm. Forma e renditur në krye **kompjutër** na duket e fytyrëzuar mirë në shqip, jo vetëm sepse është shkruar ashtu siç shqiptohet

⁶A. Dodi, *Rreth problemeve të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe*, "Studime filologjike", 4, 1973, f. 124. Autori nënvizon: "Në ligjërimin bisedor i-ja këtu nuk shqiptohet fare, sidomos tek fjala *higjienë* që ka një përdorim të gjerë".

Në ndonjë rast drejtshkrimi ka pasqyruar shqiptimin, për shembull: *studioj*, por jo për *studio* (është ndarë drejtshkrimi i këtyre dy fjalëve, për mendimin tonë, me pa të drejtë.). Shih edhe: Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, T. 1976.

⁷ Q. Murati, *Drejtpërdorimi i shqipes dhe kultura gjuhësore*, Shkup, 1996, f. 101.

Fjalë të huaja – huazime dhe prurje të huaja

në gjuhën dhënëse, por edhe sepse kështu ajo i ngjizet më mirë leksikut të gjuhës shqipe, pasi gjen aty gjedhet e saj: *kompjutër-kompjutri*, si *libër-libri*. Arrijmë në këtë përfundim edhe nga një vëzhgim i përdoruesve të kësaj fjale. Në përgjithësi, përdorues të arsimuar dhe me kulturë gjuhësore, si dhe specialistë të fushës së gjuhës kanë përdorur formën *kompjutër*.

Kështu, një program akademik për fjalët e huaja të futura rishtas në gjuhën shqipe diktohet nga koha jonë, që përjeton rrethana të veçanta në kushtet e një shtypi gjuhësisht të shkapërderdhur, në kushte krijimesh e përkthimesh jo të nivelit të duhur gjuhësor, ku gjithnjë përballemi me *prurje të huaja*⁸, fare të panevojshme që nuk kanë të bëjnë me veprimin e huazimit (ang. borrowing). Në FGJSSH (1980) jepet ky shpjegim semantik për huazimin: “Fjalë a njësi tjetër gjuhësore që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare”. Ky përkufizim i përmbledhur, i krahasueshëm vetëm deri diku me përkufizime fjalorësh të tjerë⁹, ku vihet në dukje edhe fytyrëzimi i huazimeve me përdorim të gjerë, fsheh një teori të tërë, e cila, me kujdesin e duhur, zbulohet qartë në mendimin teorik shqiptar për këtë problem, ku, hapësira emërtuese e termit *huazim* është e bigëzuar. Nga njëra anë, me këtë term nënkuptohen në gjuhësinë tonë vetëm ato fjalë a njësi të leksikut të jashtëardhur, të cilat sjellin nocione të reja, zgjerojnë shprehjen e mendimit nëpërmjet nuancave kuptimore plotësuese që mbartin dhe e bëjnë atë të aftë të luajë rolin e vet në degëzimet e pafund të komunikimit gojor e shkrimor. Nga ana tjetër, ky leksik i jashtëardhur s’është gjithmonë i tillë. Ai perceptohet e futet në përdorim në mënyrë tejet subjektive nga “...njerëzit që jetojnë brenda një njësie gjuhësore, ku niveli i kulturës, d.m.th. dija, nuk është e njëjtë për të gjithë”¹⁰, duke hapur kështu rrugë për thithje negative të lëndës së huaj gjuhësore, madje në një shkallë tepër të pahijshme, ushqyer nga një nënvleftësim i gjuhës amtare dhe nga një prirje e pakuptimtë e përdorimit të fjalëve e strukturave të huaja¹¹, sidomos në reklama tregtare, ku fjala shqipe është mënjanuar. Fjalë të tilla me burim të huaj në gjuhësinë shqiptare, më së shumti, janë quajtur *huazime të panevojshme*. Ne mendojmë se termit *huazim* i duhet dhënë funksion emërtues vetëm për leksikun e jashtëardhur që ndikon pozitivisht në pasurimin e gjuhës, që është asimiluar dhe si i tillë është pasuri dhe nuk mund të jetë i panevojshëm, ndërsa pjesa tjetër që hyn në përdorim pa nevojë dhe ndërpret komunikimin për shkak të paqartësisë kuptimore, duhet veçuar nga ky

⁸ Termi *prurje e huaj* është përdorur për herë të parë si term dallues gjuhësor në: R. Stringa, Gjuha shqipe – arritje dhe shqetësime (Emision televiziv në ETV, korrik 1998), shih edhe 9 prill 2009, Fjala e lirë, samp.a.com

⁹ **huazim (borrowing)** Shih Oxford Dictionary of English Grammar, S Chalker & E. Weiner, Fjalë ose njësi tjetër e cila është marrë nga një gjuhë dhe përdoret në një tjetër. Kur huazimi është një fjalë e vetme quhet **fjalë e huazuar** (loan word). Ndonjëherë folësit përpiqen t’i shqiptojnë huazimet, ashtu si ato shqiptohen në gjuhët dhënëse. Megjithatë, nëse fjala e huazuar ka përdorim të gjerë, shumica e folësve e shqiptojnë atë sipas sistemit fonetik të gjuhës së tyre.

¹⁰ Sh. Rrokaj, Strukturalizmi klasik në gjuhësi, T. 1994, f. 136.

¹¹ Q. Murati, Gjuha dhe shkolla shqipe sot, Gjuha dhe ligjërimi në shkollë, Sh. 1998, f. 69.

term. Për këtë pjesë të *fjalëve të huaja* (*foreignism*¹²), që e veçuem nga termi *huazim* kemi përdorur një term më të specializuar kuptimisht: *prurje e huaj*. Këtu përfshihen përshtjellimet semantike, keqshqiptimet, fjalët konfuze, paronimet, dysorët e gabuar fonologjikë, semantikë e grafemorë. Ky veçim është i domosdoshëm, po të kihet parasysh se jetën e sotme shqiptare e karakterizon një rrugë e përbashkët me zhvillimet moderne evropiane.

Skema 1

Fjalë të huaja (foreignism)

Huazime (borrowing)

Prurje të huaja (Confusible¹³ etj.)

Teoria e pastrimit dhe e pasurimit të një gjuhe, është e njohur edhe në gjuhë të tjera, por kryesisht është zbatuar në gjuhësinë shqiptare për shkak të rrethanave të veçanta historike, shoqërore e kulturore të zhvillimit gjuhësor, ku “Ndërsa për të gjitha gjuhët çështja e pastërtisë ka rëndësi të madhe, për gjuhën shqipe kjo është çështje jetike”¹⁴. Pajtohemi me mendimin se “Ka qenë një konstante në gjuhësinë shqiptare përpjekja për mënjanimin e fjalëve të huaja, ose, e thënë ndryshe, për pastërtinë e gjuhës. Popujt e rrezikuar për t’u asimiluar nuk mund t’i shpëtojnë rrezikut pa u kujdesur në radhë të parë për gjuhën e tyre. Këtë kanë bërë dhe bëjnë edhe shqiptarët.... Gjuha është një vlerë kombëtare që nuk mund të mbetet jashtë kujdesit shtetëror e shoqëror”¹⁵, por duke i veçuar kështu edhe terminologjikisht fonemat, morfemat fjalët, kuptimet e modelet kuptimore që kanë hyrë nga gjuhët e huaja pa kompetencë e pa nevojë, skicohet e zbatohet më mirë një mendim strategjik për pastrimin e pasurimin e gjuhës shqipe, që do të mbështetej në tri drejtime kryesore:

a) Fjalët e huaja të futura rishtazi në gjuhën shqipe ose të fytyrëzohen e të kthehen në huazime kur janë të nevojshme si të tilla ose të zëvendësohen e të kalkohen me lëndë gjuhësore vendi kur është e mundshme ose, më në fund, të shkruhen brenda tekstit shqip në një mënyrë të dallueshme, p.sh. me gërma ndryshe, siç ndodh në ca gjuhë të tjera.

¹² **fjalë e huaj (foreignism)**

Fjalë ose shprehje e huaj që kopjohet e përcillet nga një gjuhë në një tjetër, por që ende nuk është ‘asimiluar’ plotësisht dhe shpesh (në tekste angleze) paraqitet me gërma italiane. Në disa raste, puristët i qortojnë fjalët e huaja si një ndotje e pashëndetshme, p.sh. *franglais* në frëngjisht dhe *Fremdwörter* në gjermanisht.

¹³ **fjalë konfuze.** Një term jozyrtar për çiftet ose grupet e fjalëve që shkaktojnë përshtjellim në marrëdhëniet e komunikimit gjuhësor. Më konkretisht të tilla janë fjalë me veshje tingëllore të ngjashme ose me ngjashmëri në formën e të shkruarit, në kuptim apo në prejardhjen etimologjike.

¹⁴ Marko La Piana, *Purezza di vocaboli e correttezza di stile*, “Albania Nuova” Tiranë, 1958, nr. 1, f. 33.


¹⁵ E. Lafe, *Rreth përdorimit të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe*, <http://lajme.dervina.com/archive/>

Fjalë të huaja – huazime dhe prurje të huaja

b) Huazimet, me ngjyrimet e tyre semantike ose si emërtime të një objekti të panjohur, e pasurojnë gjuhën, ato janë bërë e duhet të bëhen pronë e gjuhës shqipe nëpërmjet veprimit të natyrshëm të ligjeve të fytyrëzimit shqip të tyre (shqipëzimit), veprim i cili duhet ndërgjegjësuar.

c) Prurjet e huaja të mënjanohej në mënyrë tërësore nga të gjitha hallkat e sistemit tonë gjuhësor me mjete dhe forma urdhëruese zyrtare.

Skema 2



Skicimi i këtij mendimi strategjik për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, tashmë jo vetëm teorik, por praktikisht i përcaktuar qartë në mënyrë të tillë që pastrimi të veprojë mbi prurjet e huaja e jo mbi huazimet që nga ana e tyre janë pasurim, duhet të organizojë politikën gjuhësore të zvogëlimit të arsyeshëm të fjalëve të huaja, ku si mjet baraspeshimi, krahas shndërrimit të tyre në huazime, të shërbejnë edhe rezervat dialektore, fjala e rrallë shqipe e mbledhur në të dyja anët e Shkumbinit, që fle nëpër revista e fjalorë krahinorë. Do të sigurohej kështu një nga mënyrat më të frytshme që njëherësh do të pasuronte dhe pastronte gjuhën standarde shqipe dhe do të ruante origjinalitetin e saj. Ndërsa prurjet e huaja të shikohen si mish i huaj dhe për to të bëhet planifikimi i mënjanimet me mjete urdhëruese. Ato nuk kanë lidhje me demokracinë apo lirinë e shprehjes së mendimit. Aftësinë dhe, si pasojë, edhe të drejtën për ta bërë këtë punë e kanë vetëm akademitë dhe universitetet shqiptare, filologët e shkrimtarët tanë, të cilët jo vetëm që duhet të zbulojnë vlerat semantike të fjalës së rrallë shqipe, por të bëjnë edhe inventarizimin e fjalëve shqipe të harruara apo të lëna mënjane. Vetëm atëherë “Kjo lëndë e mbledhur jep dorë edhe për një varg studimesh që çojnë përpara shkencën leksikologjike e leksikografike shqiptare dhe zgjerojnë horizontin e mësuesve, ngrenë formimin e tyre gjuhësor, i ndihmojnë modernizimit të lëndës së gjuhës shqipe në përmbajtje dhe në metodë”¹⁶. Kjo punë nuk duhet të jetë vetëm teoriko-udhëzuese, por e mbështetur në lëndë gjuhësore të studiuar dhe të sistemuar (si rezervë për veprim) nëpër “Fjalorthet e teksteve, me pikësynime të përcaktuara drejt, sipas vlerave të njësive leksikore, frazeologjike e semantike...”¹⁷. Ky konceptim duhet të vështrohet si qëllim e synim nëpër shtigjet e zhvillimeve të sotme brenda gjuhës sonë që ecën në rrugën e vet. Ndërsa kjo rrugë ka fundvijë (horizont) të gjerë vëzhgimi, fusha e veprimit në të shkuarën e gjuhës është më e kufizuar dhe bërthamën e saj e përbën kthimi në jetë i fjalëve të vjetra, që janë harruar nëpër shkrime të dikurshme. Ndryshe do ta kemi vetë përgjegjësinë në ndjekjen e rrotës së evoluimit të natyrshëm e origjinal të gjuhës sonë. Një rrugë e tillë s’është fare e parrahur në historinë e gjuhës sonë. K.

¹⁶ J. Thomai, M. Samara, A. Sinani, “Studime filologjike”, 1, 1987, f. 40.

¹⁷ J. Thomai, M. Samara, A. Sinani, Po aty.

Kristoforidhi me zellin e gjuhëtarit të mirëfilltë përfshin në fjalorin e tij “...mbi 450 fjalë të marra drejtpërdrejt nga Bogdani. Ato kanë hyrë tashmë në fondin e përgjithshëm të gjuhës”¹⁸. Gjersa këto veprime kanë qenë të pjesshme dhe vetëm me frymë dëshire nga individë gjuhësisht të edukuar, lind nevoja e ligjësimit gjuhësor të tyre, i cili mundësohet vetëm nga statusi i gjuhës shqipe që duhet të miratohet me dekrete parlamentare.

¹⁸ A. Kostallari, Seminar ndërkombëtar për gjuhën..., P. 1995, f. 67.